

DY NXËNËS SHQIPTAR - KRENARIA E NJË SHKOLLE AMERIKANE

NGA GJEKË MARINAJ-TEXAS

Egri Laçi dhe motra e tij Bora Laçi nuk e ndajnë veten të jashtëzakonshëm midis nxënësve të klasës ku ata bëjnë pjesë. Por mësuesit e tyre u referohen atyre si "krenaria e Shkollës së Mesme të Richardsonit."

Ky nuk është një kompliment i vogël, aq më tepër kur vjen nga Monica Simonds, e cila është edhe intervistesja e studenteve që kandidojnë për t'u pranuar në këtë shkollë.

Richardson High School gjendet në shtetin e Teksasit, në Amrikë. Egri dhe Bora studiojnë aty që nga shtatori i vitit që sapo kaloi. Ajo është vënë në funksion që në vitin 1900, dhe është e njohur për programet e avancuara akademike sidomos në shkollën e Arteve, Drejtësisë dhe të Shkencës.

Të dy, pasi i kanë studiuar opsionet që afronte kjo shkollë, kanë vendosur t'u përvishen studimeve në fushën e drejtësisë.

"Dua të bëhem avokat që të ndihmoj njerëzit në marrëdhëniet e tyre me ligjin dhe të zbatoj disa nga ligjet që unë besoj se duhen zbatuar nga të gjithë," thotë Egri.

Në të njëjtën kohë Bora shton: "Unë dua të ndihmoj të varfërit, t'ua shpjegoj të drejtat ligjore që kanë dhe të luftoj që ato u jepen edhe atyre si të gjithë amerikanëve të tjerë.


Nga ky program para-ligjor ata vazhdojnë të marrin njohuritë e domosdoshme për të shkuar në kolegji të përgatitur për programet e avancuara të drejtësisë."

Një numër i mirë nga studentët e shkollës në fjalë kanë shkëlqyer në disa nga universitetet më me zë të Amerikës. "Ata i kuptojnë profesorët e drejtësisë që në ditën e parë që gjenden pran tyre, sepse ata ulën në klasë me vetëbesimin dhe njohuritë që fitojnë gjatë katër vjetëve në Richardson High School," thotë Monica Simonds, e cila është mësuesja kryesore e lëndës së para-ligjit.

Natyrisht, jo të gjithë mësuesit në këtë program janë avokatë. Simonds është diplomuar në fushën e komunikimit, por drejtori i programit ka qenë avokat dhe Kryetar Gjykatë, para se të pranonte detyrën e mësimit në këtë shkollë. Kjo gjë ai ka shtuar reputacionin shkollës dhe programit, sepse vetëm dëshira për të ndihmuar studentët, si Egri dhe Bora, ka bërë që një kryetar gjykatë të lënë pagesën e "majme" që kishte për një pagesë disa herë më të ulët, siç është ajo e një drejtori.

Ata janë të dy në të njëjtin program dhe në të njëjtën klasë. "Kur nuk duan që të tjerët të jenë pjesë e bisedës së tyre ata flasin shqip dhe jo anglisht," shton me të qeshur Simonds.

Por Egri dhe Bora në kanë ndarë në grupe të ndryshme pune. Të gjithë studentët i caktojnë të punojnë në grupe, brenda klasës, të moderuar nga mësuesit përkatës.



Egri dhe Bora Laçi

Sepse në këtë shkollë programi i drejtësisë është vërtet program konkurrues.

Mësuesja Simonds thotë se "Jam akoma duke pritur që të i kundërvihen njëri-tjetrit në seksionin e debatit, por akoma nuk ka ndodhur një gjë e tillë midis tyre. Në fakt, ata shkojnë aq mirë me njëri-tjetrin sa nganjëherë është e çuditshme."

Simonds midis tjerash komenton se vëllat e motër rinë gjithmonë të qeshur, gjithmonë të gëzuar. Ajo vë në dukje edhe cilësi të tjera të dy studentëve shqiptar, por mbi të gjitha vlerëson etikën e çuditshme të punës së tyre: "Nëse të gjithë studentët do të punonin me këmbënguljen e Iglit dhe Borës, të gjithë do të fitonin nota shumë më të mira se ç'fitojnë."

Mësuesit e tyre janë në dijeni se ata mësojnë së bashku në shtëpi. Kjo praktikë punë do të ishte një dobësi për ata studentët që duan të japin minimumin—sa për të kaluar klasën dhe kohën, por për Iglin dhe Borën, është një avantazh i madh, sepse ata shtypnë njëri-tjetrin për më të thellësi të studimeve.

Fjala thellësi për Egri ka kuptim të thellë si nga përmbajtja e fjalës ashtu edhe nga mënyra se si distribuohet ajo.

"Këtë vit po futemi më në thellësi të njohjes të së drejtave të njeriut, sidomos të Amendamentit të Parë Amerikan. Unë nuk e dija se do të shkonim kaq në thellësi të këtij

Amendamenti," thotë Egri.

Bora ndërhyrë më të njëjtin entuziazëm: "Sidomos njohuritë kundrejt lirisë së fjalës dhe të fesë më kanë shtyre edhe më tej drejt dëshirës për ta vazhduar programin e drejtësisë në këtë shkollë."

Bora është një vajzë aq e matur, e sjellshme, dhe e butë nga natyra sa të bën të mendohesh se nga do i vijë agresiviteti i nevojshëm për të praktikuar profesionin e avokatit. Kuptohet se arma më e mirë e një avokati është forca argumentuese dhe agresiviteti me të cilin e zbulon dhe e paraqet evidencën para jurisë dhe gjykatës, por për ta futur lexuesin më në tej në botën e saj ai shtruan atë si problem të mundshëm në zanatin e ardhshëm të saj.

"Agresiviteti vokal dhe fizik janë metoda që nganjëherë ecin me kahe të kundërta me rezultatin e dëshiruar në fushën e drejtësisë. Megjithatë ne i kemi orët e debatit profesional të cilave u jap vëmendjen e duhur," reagon Bora.

Analogji e kënaqshme për një vajzë në vitin e parë të shkollës së mesme, hë?!

As Igli as Bora nuk janë të shqetësuar për këtë. Kjo, pjesërisht, se vitin që vjen ata do të kenë seanca gjyqësore ku të gjithë studentët do të luajnë rolet e tyre jo vetëm si avokatë, por edhe si juri e gjykatës. Gjatë këtyre seancave ata do të mësojnë rreth shkallës dhe llojit të agresivitetit të domosdoshëm profesional, dhe të mënjanimin të strategjive joefektive në drejtësi.

Megjithatë, duke u mbështetur te mësuesja, Monica Simonds, Bora, në klasë, nuk heziton të këmbëngulë për të mbështetur argumentet e saj ligjore: "Nëse ajo e ndjen se një ngritje e kontrolluar zëri apo një ekspresion i veçantë në fytyrë do e ndihmon argumentin e saj, ajo nuk heziton fare t'i përdorë në të mirë të argumentimit të saj ato."

FRËNGJISHTJA, GJUHA QË DUAN TA MËSOJNË SA MË PARË

Një nga lëndët e tjera ku Igli dhe Bora shkëlqejnë është edhe klasa e frëngjishtes. Ata, gjithsesi, e ndajnë suksesin me mësuesen e tyre: "Mësuesja jonë, zonja Alicia D. Powers, është një mësuese e mrekullueshme. Ajo na jep leksione pa libër përpara," thotë Igli.

Natyrisht, nëse duan t'i përdorin tekstet shkollore, ata mund t'i blejnë, por kohën e klasës e ruajnë për komunikim direkt në gjuhën franceze dhe për mësimin e teknikave më të mira të mbajtjes mend të fjalëve dhe të përdorimit të tyre me efikasitet në fjalë.

Igli shton se "Gjëja më e mirë është se ajo (Alicia D. Powers) na e bën të pëlqyeshme orën e frëngjishtes, duke na e mënjnuar çdo mundësi të pasivitetit në klasë. Falë zonjës

Powers, tani di më shumë fjalë nga fjalori i gjuhës franceze se ç'kam ditur ndonjëherë më parë."

Padyshim edhe Bora ka të njëjtin mendim me të vëllanë e saj: "Po është e vërtet. Mësuesja jonë e frëngjishtes gjithmonë mendon se si ta bëjë klasën më aktive. Ne bëjmë përgatitje për provime, lojëra të ndryshme fjalësh, ku inkorporohen fjalë dhe strategji rreth vendosjes së tyre në fjalë. Ato na ndihmojnë t'i mbajmë mend më mirë fjalët dhe shprehjet."

Për mësuesen e tyre, Alicia D. Powers, strategjia e mësimdhënies ka të bëjë me rrugën që arsimtarët zgjedhin për të depërtuar tek magnetizmi mendor i studenteve: "Mënyra e organizimit dhe puna krijuese për të analizuar dhe pasuruar aftësitë e nxënësve është e rëndësishme jo vetëm për mua personalisht, por edhe për të gjithë arsimtarët e tjerë të departamentit të gjuhëve të huaja të kësaj shkolle. Natyrisht po t'i kishim të gjithë studentët aq të shkëlqyer sa ç'kemi Iglin dhe Borën, puna jonë do të ishte shumë më e lehtë dhe rezultatet e studentëve do të ishin shumë më të larta."

Pikërisht për këtë fakt, ajo është në largim e sipër nga tekstet shkollore, nga mënyra e mësimin me tabelat e foljeve, të gramatikës dhe të formulave të tjera tradicionale për të ndjekur metodat formale të komunikimit verbal. Kjo është një ndjekje më natyrale e efekteve gjuhësore. Studentët nuk mësojnë vetëm një listë prej 20 apo 30 fjalësh në ditë, por përvetësojnë fjalë ku përfshihen direkt objektet, emrat e mbiemrat, artikujt e gjinive mashkullore dhe femërore si dhe pjesët e tjera të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar.

"Ne ua mësojnë shprehjet 'të plota' studentëve për t'u lënë vend që fjalorin ta mësojnë në mënyrë më spontane dhe më të qëndrueshme. Nuk është se nuk flasim fare për tërësinë e gjuhës, por strategjia jonë është t'u mësojnë nxënësve 'të plotën' dhe jo vetëm disa nga pjesët e gjuhës frëngjishte," thekson Powers.

Kjo është një ndihmë madje edhe për Iglin e Borën. Ata nuk kanë nevojë t'u referohen listave të fjalëve të mësuara që të shohin nëse aty gjenden të gjitha fjalët e nevojshme për të ndërtuar fjalë koherente gjatë bisedës apo shkrimit...

BASHKËPUNIMI MËSUËS, NXËNËS DHE PRINDËR ËSHTË PJESË E SUKSESIT TË IGLIT DHE BORËS

Jean Chapman është mësuese e gjeografisë pran Shkollës së Mesme të Richardsonit. Ajo shpjegon: "Edhe unë i kam në klasë në të njëjtën kohë Iglin dhe Borën. Kam mbetur vërtet e kënaqur për bashkëpunimin midis tyre.

Chapman shton se i njeh mirë edhe prindërit e Iglit dhe Borës. "Jam në dijeni se Mirjami ka kërkesa të mëdha ndaj fëmijëve të saj dhe ndaj nesh si mësuesit e tyre. Ajo na e ka shprehur shqetësimin e saj rresh mënyrës së mësimdhënies pa tekste. Madje më ka thënë se kërkon prej meje që fëmijët e saj të flasin frëngjisht rrjedhshëm para fundit të këtij viti. Dhe unë mendova—'rrjedhshëm(!)' brenda një viti shkollor(!) kur për ta arritur atë nivel mua më është dashur të kryej 16 vjet shkollë! Sidoqoftë, më kanë dhënë për të kuptuar se kërkesat e tyre janë maksimale, dhe unë i respektoj qëllimet e tyre.

Ajo që mësuesja e dy fëmijëve shqiptar—me origjinë nga Korça—nuk e dinte, është se Mirjami ka qenë vetë mësuese në Korçë dhe se ajo i di mirë limitet dhe mundësitë e fëmijëve për të avancuar në jetën akademike. Pavarësisht nga rezultatet e arritura deri tani, që për shumicën e fëmijëve mbeten një "ëndërr", të dyja palët mundohen të arrijnë maksimumin e asaj që mund të arrihet nga Igli dhe Bora Laçi.

Tashmë është e vërtetuar nga studiuesit akademikë se sa më të përfshirë që të jenë prindërit në jetën akademike të fëmijëve të

tyre, aq më të suksesshëm ka gjasa të jenë fëmijët.

Shumica prej nesh jemi të ndërgjegjshëm se sidomos në shoqërinë shqiptare, ka studentë që prindërit e tyre janë të kënaqur nëse ata e kalojnë klasën. E vërteta është se shumë nga fëmijët shqiptarë kanë mundësi shumë më të mëdha suksesi se sa ç'tregojnë notat e tyre. Për këtë Chapman thotë se "Unë i admiroj prindërit e Iglit dhe të Borës për punën e vyer që bëjnë për fëmijët e tyre."

Gjatë intervistave për këtë artikull mësova rreth regjimit që ndjekin gjatë jetës shkollore Igli e Bora. Pas përfundimit të orëve të mësimin ata shkojnë në shtëpi dhe sapo hanë drekë shkojnë menjëherë të flenë për dy orë (afërsisht nga ora 7 deri në 9 të mëngjesit). Pas zgjimit fillojnë mësimet dhe i vazhdojnë ato deri në orën 1 pas mesnate. Pastaj shkojnë të flenë edhe për 6 orë të tjera për të plotësuar 8 orë gjumë, të cilat sipas këshillave të mjekëve janë të mjaftueshme edhe për fëmijët.

Dikush mund të mendojë se një regjim i tillë për fëmijët është disi ekstrem, ndoshta i rrezikshëm, por mësuesit dhe prindërit e këtyre dy fëmijëve, Gëzim dhe Mirjam Laçi, mendojnë të kundërtën.

"Nga kultura," thotë Chapman, "Bora dhe Igli janë shumë më të avancuar se fëmijët e familjeve normale amerikane."

Një tjetër aspekt që nxënësit Laçi vlerësojnë maksimalisht është fakti se për shkollën e mesme të Richardson-it komunikimi me prindërit është vendimtar. Në fakt është përgjegjësia e mësuesëve që të komunikojnë me prindërit e studentëve në mënyrë të herëpashershme.

Ata kanë përdorur teknika komunikimi duke përfshirë dëftesa, letra me komente specifike për Iglin dhe Borën në lidhje me progresin studimor dhe pjesëmarrjen e tyre në klasë. Edhe konferenca individuale, telefonatat apo komunikime me anë të formave të ndryshme elektronike janë zhvilluar midis familjes Laçi dhe përfaqësuesëve të shkollës. Për këtë mësuesit nuk presin deri në fund të semestrit, por veprojnë për çdo tri javë.


Këto lidhje i kanë dhënë rezultatet e veta që në semestrin e parë. Nga një anë, zgjuarsia e Iglit dhe Borës e ka ndihmuar shkollën e mesme të Richardsonit. Në ç'mënyrë? Mësuesit në fillim të çdo semestri u afrojnë studentëve një program me kohë të caktuar për ndihmesë akademike jashtë orarit të rregullt shkollore. Ndonjëse kombinimi kohor që mësuesit afrojnë është zakonisht në përputhje me nevojat e çdo studenti, koha e para-programuar nganjëherë nuk është në akord me nevojat e disave prej tyre. Kështu, jo vetëm që koha e caktuar për Iglin dhe Borën u është dedikuar studentëve që kanë pasë nevojë për më shumë vëmendje individuale, por edhe ata vetë gjatë kësaj kohe i ndihmojnë me dedikim shokët e tyre të klasës.

Ndihmesa e dy fëmijëve shqiptar nuk ka mbetur në hije. Ajo është vërejtur edhe nga Jean Chapman: "Ata i ndihmojnë me shumë dëshirë studentët e tjerë, të cilët i kam parë disa herë t'u drejtohen Iglit dhe Borës për ndihmë. Mendoj se kjo dëshirë për të ndihmuar të tjerët është një tjetër kualitet i vyer i tyre."

Kur mësuesit, nxënësit, dhe prindërit marrin përsipër pjesën e përgjegjësisë së tyre për efektivitetin e progresit të nxënësve, në shumicën e rasteve është e mundur që të kemi më shumë nxënës si Igli Laçi dhe Bora Laçi, si në Shqipëri ashtu edhe në Amerikë.

Mbi të gjitha, paqja dhe mirëkuptimi midis njerëzve janë pjesë kyçe e drejtësisë. Egri Laçi dhe Bora Laçi po edukohen që ato t'i bëjnë pjesë të edukimit të njeriut të sotëm jo vetëm shqiptar apo Amerikanë, por pjesë e njeriut kudo në Botë.

"Drejtësia për mua është një mrekulli, sidomos dega ime, pra dua të ushtrij detyrën e avokatit edhe në fushën e biznesit e korporatave, të gjendem në qendër të problemeve të kompanive të mëdha dhe t'ua përkushtoj të gjitha njohuritë e mija atyre," thotë në përfundim 14-vjeçari Igli Laçi.



Bora (majtas) së bashku me tri mësueset